



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
DREJTORIA E PËRGJITSHME E POLICISË SË SHITETIT  
AKADEMIA E SIGURISË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 14/2  
dt. 19.04.22.

V E N D I M

Nr. 07/, datë 19.04.2022  
12

P Ë R

**NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 07 DATË 04.04.2022 "PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES SË ADMINISTRATORIT TË AKADEMISË SË SIGURISË"**

Në zbatim të gërmës "F", pika 1, neni 49 dhe neni 51 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", pikës 5 dhe 6 të VKM nr. 88 datë 28.10.2020, "Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit e saj", i ndryshuar me VKM Nr. 320, datë 02.06.2021, të Urdhërit nr. 385 datë 21.12.2021 të Ministrit të Brendshëm "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Akademisë së Sigurisë".

Duke administruar, vlerësuar dhe analizuar ankesën e shtetasit J.S., të datës 15.04.2022 drejtuar Kryetarit të Bordit të Administrimit, i cili arsyeton se në kriteret e përzgjedhjes së Administratorit është vendosur që kandidati duhet të dorëzojë dëshmi të gjuhës angleze në nivelin B2 dhe se ky kriter është skualifikues, duke sqaruar më tej se: "Në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 51, pika 4 përcakton se: Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i Shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha. Përsa më sipër, asnjë vendim në përcaktimin e kriterit skualifikues, nuk duhet të kapërcejë ato të përcaktuara qartësisht në ligj...".

Në zbatim të pikës 4 të nenit 51, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Bordi i Administrimit konstaton se është një kriter që Ligji Nr. 80/2015, nuk e parashikon, pavarësisht se Bordi e ka parashikuar kriterin e gjuhës : huaj në kriteret e përzgjedhjes së Administratorit të AS sipas Vendimit nr. 07 datë 04.04.2022, me qëllim për të ofruar kandidatë me një formim sa më cilësor në këtë funksion;

Nisur nga fakti se ky pozicion pune është i tillë që nuk do të ketë marrëdhënie dhe komunikime jashtë, si dhe nuk do të ketë kontakte me të huaj, por kryesisht ai do të jetë autoriteti më i lartë administrativ përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit dhe që do të raportojë rregullisht për aktivitetin e tij përpara rektorit dhe Bordit të Administrimit;

Bordi i Administrimit të Akademisë së Sigurisë, me qëllim për të pasur një konkurim ligjor, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë kandidatët, në mbledhjen e tij;

### VENDOSI:

1. Në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 07 datë 04.04.2022 "Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së administratorit të Akademisë së Sigurisë", pikë 6 e rubrikës "Kritere të Përgjithshme" dhe pikë 10 e rubrikës "Kandidatët konkurentë për Administrator në Akademinë e Sigurisë, do të paraqesin këto dokumente.", të hiqen.
2. Ky Vendim i Bordit të Administrimit lidhur me këtë ndryshim në kriteret e përzgjedhjes së Administratorit të Akademisë së Sigurisë, të dërgohet zyrtarisht nga Akademia e Sigurisë për publikim në Agjencinë e Prokurimit Publik, në vijim të njoftimit të Buletinit nr. 46 datë 11.04.2022.
3. Vendimi i Bordit të Administrimit të dërgohet në Senatin Akademik të AS dhe të vendoset në faqen zyrtare të Akademisë së Sigurisë.
4. Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar brenda 2 (dy) javësh nga nesërmbja e shpalljes së njoftimit në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### BORDI I ADMINISTRIMIT I AKADEMISË SË SIGURISË



**KRYETARI**

**Ilhert DERVISHAJ**

**ANËTARË**

**Ednart MERKAJ**

**Eda GJOKA**

**Tonin VUÇAJ**

**Neritan NALLBAJ**

**Arjan ZOTO**

**Iva HOXHA**